

VENDIM
Nr.636, datë 24.12.1999

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.785, DATË
17.12.1998 “PËR DHËNIE SHPËRBLIMI TË MENJËHERSHËM DHE NDIHMË MUJORE 5
FËMIJËVE TË ZONJËS MIRELA ELEZI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993, “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Pika 2 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.785, datë 17.12.1998 të ndryshohet si vijon:
“Secili fëmije icaktohet një ndihmë mujore në shumën 5000 (pesë mijë) lekë, deri në moshën 18-vjeçare, në rast se fëmija vazhdon shkollën me shkëputje nga puna. Ndihma ndërpritet para kësaj moshe, nëse fëmija hyn në marrëdhënie pune.

2.Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e ndihmës ekonomike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta